LIGJ
Nr.7597, datë 31.8.1992

PËR SHËRBIMIN E KONTROLLIT TË SHTETIT

Në mbështetje të neneve 16 dhe 41/a të ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Shërbimi i Kontrollit të Shtetit është organi më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar shtetëror me objekt organizimin, drejtimin dhe realizimin e kontrollit për zbatimin e buxhetit të shtetit, administrimin e pronës shtetërore, burimet dhe përdorimin e të ardhurave të ndërmarrjeve shtetërore e të institucioneve, si dhe për përdorimin e fondeve materiale e financiare të dhëna në administrim nga shteti organizatave shoqërore e politike.

Neni 2

Shërbimi i Kontrollit të Shtetit në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e pranuara të së drejtës ndërkombëtare, kontrollon ligjshmërinë, rregullaritetin, rentabilitetin, dobishmërinë, ekonomicitetin dhe efiçiencën e veprimtarisë ekonomiko-financiare shtetërore.

Në ushtrimin e kompetencave të tij, Shërbimi i Kontrollit të Shtetit është i pavarur dhe i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit.

Neni 3

Shërbimi i Kontrollit të Shtetit, në përputhje me kompetencat e përcaktuara nga ky ligj, ushtron kontroll e kryen revizion ekonomiko-financiar në Këshillin e Ministrave, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, Bankën e Shqipërisë, bankat shtetërore të nivelit të dytë, në organet e administrimit lokal, në institucionet buxhetore, në ndërmarrjet shtetërore dhe ato të përbashkëta, në forcat e armatosura, si dhe në partitë dhe organizatat politike e shoqërore vetëm për fondet e dhëna nga buxheti i shtetit.

Shërbimi i Kontrollit të Shtetit ushtron kontroll në aparatin e Kuvendit Popullor dhe në Kabinetin e Presidentit për përdorimin e fondeve materiale e financiare.

Neni 4

Shërbimi i Kontrollit të Shtetit ka këto detyra:

1. Kontrollon në organet qendrore e lokale zbatimin e buxhetit të shtetit, ligjshmërinë dhe efektivitetin e përdorimit të fondeve materiale e financiare të caktuara për plotësimin e programeve shtetërore.

2. Kontrollon marrëdhëniet e kreditit ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe buxhetit të shtetit, si dhe zbatimin e ligjshmërisë për emetimin e kartmonedhës e të veprimeve të tjera financiare, që do të përcaktohen në rregulloren e veçantë.

3. Kontrollon korrektësinë e llogarive, rregullaritetin, rentabilitetin, dobishmërinë, ekonomicitetin si dhe efiçiencën e përdorimit të thesarit të shtetit.

4. Kontrollon ligjshmërinë, rregullaritetin e dobishmërinë e privatizimit të pronës shtetërore.

5. Kontrollon zbatimin e ligjeve e të rregullave financiare nga organet tatimore, doganore, si dhe nga policia financiare.

6. Kontrollon veprimtarinë financiare të organizmave, misioneve dhe agjencive shtetërore që

veprojnë brenda e jashtë shtetit dhe që financohen nga buxheti i shtetit.

7. Kontrollon veprimtarinë investuese shtetërore. Shqyrton ligjshmërinë dhe efektivitetin e përdorimit të burimeve të financimit, të akorduara për porositë shtetërore, në ndërmarrjet dhe organizmat e tjerë. Kur porositë shtetërore u përkasin personave juridikë privatë, Shërbimi i Kontrollit të Shtetit ushtron kontroll vetëm në ato raste kur kjo është e parashikuar shprehimisht në kontratën midis shtetit e personit juridik privat.

8. Kontrollon përdorimin e fondeve të dhëna nga buxheti i shtetit për partitë dhe organizatat e tjera politike e shoqërore.

9. Kontrollon zbatimin e rregullave të caktuara me ligj për mbajtjen e kontabilitetit e të dokumentacionit për administrimin e vlerave materiale e monetare të shtetit. Shfaq mendim për ligjet për kontabilitetin para se ato t'i paraqiten për miratim Kuvendit Popullor.

10. Bashkëpunon me organet e larta të kontrollit shtetëror të vendeve të tjera dhe me organizatat ndërkombëtare të kontrollit dhe lidh me to marrëveshje në fushën e kontrollit ekonomik e financiar.

Neni 5

Në kryerjen e funksioneve të tij, Shërbimi i Kontrollit të Shtetit ka këto të drejta:

1. Kontrollon në objektet e parashikuara në nenin 3 mbajtjen e dokumentacionit për vlerat materiale e monetare, mbajtjen e kontabilitetit, dhënien e llogarisë dhe gjithë dokumentacionin tjetër për veprimtarinë ekonomike dhe financiare dhe që pasqyron gjendjen e lëvizjen e vlerave materiale e monetare, si dhe rregullshmërinë e shpenzimeve të tyre.

2. Kërkon nga subjektet që kontrollon gjithë dokumentacionin e nevojshëm, si dhe informacione për veprimtarinë ekonomike e financiare të tyre.

3. Merr nga bankat shtetërore dhe institucionet e kreditit të dhënat e nevojshme për operacionet dhe gjendjen e llogariveqë kontrollon, si dhe nga ndërmarrjet e organet e tjera dokumente që kanë të bëjnë me operacionet e llogaritë me këtë objekt.

4. Merr në kryerjen e kontrolleve specialistë nga fusha të ndryshme të veprimtarisë shtetërore dhe, për ata që nuk janë në marrëdhënie pune, përballon pagën e tyre.

5. Kur gjatë kontrolleve dalin probleme që janë në kompetencë të organeve të tjera të kontrollit shtetëror, Shërbimi i Kontrollit të Shtetit bën kërkesë në këto organe, përmbushja e të cilës është e detyrueshme.

6. Kërkon shfuqizimin e akteve të paligjshme e të parregullta të organeve të administratës shtetërore, që kanë të bëjnë me veprimtarinë ekonomiko-financiare. Shqyrtimi i kërkesës dhe dhënia e përgjigjes duhet të bëhen jo më vonë se 15 ditë nga data e paraqitjes, në të kundërtën çështja i paraqitet organit më të lartë.

7. Kërkon nga organet e administratës shtetërore marrjen e masave për mënjanimin e shkeljeve e të metave të zbuluara.

8. Për nëpunësit fajtorë për shkeljet e të metat e zbuluara kërkon marrjen e masave disiplinore sipas dispozitave të Kodit të Punës.

9. Shqyrtimi i kërkesave të parashikuara në pikat 8 dhe 9 dhe dhënia e përgjigjes duhet të bëhen jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes.

10. Për dëmet materiale të shkaktuara pasurisë së shtetit nga nëpunësit fajtorë, bën padi në gjykatë.

Kur nga kontrolli dalin të dhëna se është kryer një vepër penale, Shërbimi i Kontrollit të Shtetit bën kallëzim në organet përkatëse të drejtësisë.

Neni 6

Inspektorët e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit kanë këto të drejta:

1. Të njihen me dokumentacionin që ka të bëjë me veprimtarinë a çështjen që kontrollohet.

2. Të hyjë lirisht në çdo veprimtari që është objekt kontrolli i përcaktuar me ligj.

3. Të marrë nga personat zyrtarë dhe punonjësit e tjerë të dhëna të domosdoshme me shkrim e me gojë, që lidhen me kryerjen e kontroll-revizionit ekonomiko-financiar.

4. Në raste të domosdoshme të vulosë arka e agjenci, depo e arkiva dhe, kur ka të dhëna për

falsifikime ose veprime të, tjera të paligjshme, të tërheqë dokumentet e nevojshme, duke lëshuar vërtetimin përkatës.

5.Të kërkojë pezullimin e veprimeve të kundërligjshme në çdo fushë, deri në shqyrtimin nga organi përkatës.

6. Të mbajë procesverbal dhe aktkontroll me personat përgjegjës. Këta të fundit detyrohen të japin shpjegime me shkrim për pranimin ose refuzimin, brenda 3 ditëve nga data e mbajtjes së procesverbalit dhe aktkontrollit, ndryshe ato quhen të mirëqena.

7. Të propozojë masa disiplinore, zhdëmtimi e penale, sipas rastit që paraqitet.

Neni 7

Shërbimi i Kontrollit të Shtetit organizon kontrolle mbi bazën e programit që miraton kryetari i tij. Kontrolle organizohen edhe mbi bazën e kërkesës me shkrim të jo më pak se 20 deputetëve të Kuvendit Popullor.

Neni 8

Shërbimi i Kontrollit të Shtetit i paraqet çdo vit Kuvendit Popullor raport për përfundimet e kontrolleve të kryera. Me kërkesën me shkrim të jo më pak se 20 deputetëve të Kuvendit Popullor, Shërbimi i Kontrollit të Shtetit raporton edhe për kontrolle të veçanta.

Neni 9

Shërbimi i Kontrollit të Shtetit paraqet në Këshillin e Ministrave raporte e materiale që kanë të bëjnë me këtë organ, ose me ministritë e institucionet e tjera qendrore. Në rast se Këshilli i Ministrave nuk është i një mendimi me përfundimet e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit, çështja i paraqitet Kuvendit Popullor.

Neni 10

Shërbimi i Kontrollit të Shtetit ka për detyrë të bëjë publike përfundimet e kontrolleve duke ruajtur sekretin shtetëror, si dhe atë bankar.

Neni 11

Shërbimi i Kontrollit të Shtetit është person juridik. Ai ka vulën që paraqet stemën shtetërore të Republikës së Shqipërisë dhe që mban emrin e tij.

Shërbimi i Kontrollit të Shtetit ka organet e tij vartëse, të organizuara mbi bazë territori.

Në buxhetin e shtetit përcaktohen fonde të veçanta për mbajtjen e aparatit të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit.

Struktura, numri i pesonelit dhe pagat e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit caktohen nga kryetari i tij brenda fondeve financiare të miratuara.

Paga e kryetarit Shërbimit të Kontrollit të Shtetit dhe e zëvendësave të tij, caktohen nga Kuvendi Popullor.

Në marrëdhëniet me organet e pushtetit e të administratës shtetërore Shërbimi i Kontrollit të Shtetit përfaqësohet nga kryetari i tij.

Neni 12

Kryetari dhe zëvendëskryetarët e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit emërohen nga Kuvendi Popullor, me propozimin e Presidentit të Republikës për një afat prej 7 vjetësh.

Kryetari dhe zëvendëskryetarët e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit duhet të jenë me arsim të lartë ekonomik ose juridik, si dhe të kenë jo më pak se 10 vjet vjetërsi në punë në profesionin e tyre.

Kryetari i Shërbimit të Kontrollit të Shtetit dhe zëvendësit e tij mund të largohen para afatit nga detyra, kur nuk kryejnë këtë sipas rregullave të caktuara, si dhe kur kanë shkelur ligjet e

shpërdorojnë postin.

Neni 13

Kryetari i Shërbimit të Kontrollit të Shtetit thirret të marrë pjesë në sesionet e Kuvendit Popullor e të komisioneve të tij, si dhe në mbledhjet e Këshillit të Ministrave, kur merren në shqyrtim probleme ekonomiko-financiare.

Neni 14

Kryetari, zëvendëskryetarët dhe punonjësit e tjerë me funksione kontrolli në Shërbimin e Kontrollit të Shtetit nuk duhet të kenë asnjë funksion tjetër shtetëror e profesional dhe as të marrin pjesë në organizmat drejtuese të organizatave ekonomike e tregtare, përveçse të drejtës si autor e mësimdhënës.

Kryetari mund të ruajë të drejtën e mandatit të deputetit.

Kryetari dhe zëvendëskryetarët e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit gëzojnë imunitet. Ata nuk mund të kontrollohen, të ndalohen, të arrestohen, ose të ndiqen penalisht pa pëlqimin e Kuvendit Popullor.

Neni 15

Marrja në punë e personelit të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit bëhet nga kryetari i tij në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullat e përcaktuara në rregulloren e brendshme.

Neni 16

Punonjësit e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit duhet të ruajnë interesat shtetërore e mbarëkombëtare dhe të mos ndikohen në punën e tyre nga pikëpamjet politike.

Punonjësit mbajnë përgjegjësi për shtrembërimin e rezultateve të kontrollit të kryer si dhe për përhapje të sekretit që lidhet me të.

Inspektorët e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit vërtetojnë qenien e tyre në këtë detyrë me librezën përkatëse, të lëshuar nga kryetari i Shërbimit të Kontrollit të Shtetit.

Neni 17

Organet qendrore e lokale janë të detyruara të ndihmojnë Shërbimin e Kontrollit të Shtetit në realizimin e funksioneve të tij.

Punonjësit që pengojnë realizimin e kontrolleve nga Shërbimi i Kontrollit të Shtetit, kur veprimet nuk përbëjnë vepër penale, kanë përgjegjësi disiplinore.

Neni 18

Zbërthimi i detyrave të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit të parashikuara me këtë ligj, si dhe caktimi i rregullave të hollësishme për ushtrimin e veprimtarisë së këtij organi, bëhet me rregullore të miratuar nga kryetari i tij.

Neni 19

Shërbimi i Kontrollit të Shtetit mbikqyr organet e kontrollit të brendshëm ekonomiko-financiar të ministrive, institucioneve të tjera qendrore dhe të organeve të pushetit lokal.

Neni 20

Ligji "Për Komisionin e Kontrollit të Shtetit" nr.7108, datë 21.2.1987, si dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.297, datë 15.9.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.